





Republika e Kosovës
Republika Kosova.
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturu Omladinu i Sport
Department of Culture Youthand Sports

Thirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe Individeve në fushën e Kulturës.

1. Komuna e Skenderajt përkatësishtë Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Komunën e Skenderajt, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës në Komunën e Skenderajt.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte /programet e tyre për aktivitetet kulturore, të paraparë me planin e punës së Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport siç janë aktivitetet e Ditës së Çlirimtë Skenderajt 18 Qershorit si dhe muaji "Ditët e Mërgatës" i cili mbahet për nderë të bashkatdhetarëve me 12 Korrik – 25 Gusht të këtij viti, muaj përplot gjallëri me koncerthe në mbrëmje, vizita në monumente dhe vende historike, dhe poashtu me aktivitete Sportive e Rekreative.
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të kulturës i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të parapara me pikën 2 të kësaj thirrje publike.
4. Shuma e mbështetjes financiare është **19,000.00 Euro**.

Vlera totale e thirrjes publike është **19,000.00 Euro**.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është **13/05/2024**, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën **31/05/2024**.
6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara ne regjistrin e Organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Skenderajt dhe të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike, periudha e zbatimit të projektit është fundi i vitit aktual.

OJQ-të aplikuese duhet të deshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, si dhe të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore. Nëse kanë qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna Skenderaj, të justifikojnë mjetet e shpenzuara duke dorëzuar raportin finanziar.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme. Të njëjtat dëshmi duhet të i dorëzojë edhe personi fizik i cili është përfitues i mbështetjes financiare.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Skenderajt kk.rks-gov.net/Skenderaj.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në zarf të mbyllur në arkiven e komunës në adresës: "Komuna Skenderaj, rruga 28 Nentor 41000"- Skenderaj.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në **Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike**. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përbushin plotësisht kushtet e percaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: komuna.skenderaj@rks-gov.net.

Skenderaj, 14.05.2024

Drejtori:

Alban Berisha

